

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal**, Gjyqtari i vetëm gjykues Gazmend Bahtiri, me sekretaren juridike Mihrie Krasniqi-Sheholli, në çështjen penale kundër të akuzuares S. E. nga fshati H., Komuna e P., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1216/14 të dt.23.02.2016, pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur më dt.09.11.2017 në praninë e prokurorit të shtetit Rexhep Maqedonci dhe të akuzuarës, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me dt. 16.11.2017 përpiloi këtë:

## A K T G J Y K I M

### E akuzuari:

**S. E.**, nga i ati H. dhe nëna H.,e lindur më *data e lindjes...*, në fshatin Sh., Komuna e P., me vendbanim në fsh.H., K.P., me nr.personal të identifikimit: *numri personal...*, e martuar, Nënë e tre (3) fëmijëve, e pashkolluar, e papunë-amvise, e gjendjes së dobët ekonomiko-sociale, rast social, Shqiptare-Kosovare, shtetase e Republikës së Kosovës.

## Ë S H T Ë F A J T O R

### Sepse:

Prej datës së pavërtetuar e gjerë më dt. 04.12.2013, kur nga ana e personave të autorizuar të KEDS-it, është vërtetuar se me qëllim që vetës ti sjellë përfitim të kundërligjshëm pasuror, në mënyrë të paautorizuar ka shfrytëzuar energjin elektrike në shtëpinë e tij në adresë të lartcekur, në atë mënyrë që ka bërë lidhje direkte në rrjetin e tensionit të ulët, kështu që energjia e shpenzuar elektrike nuk është regjistruar, me ç'rast të dëmtuarës KEDS-it, i ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm material.

-me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së,

Prandaj, gjykata në bazë të neneve 4, 7, 17, 41, 49, 50, 51, 52, 73 dhe neni 320 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 365, 450, 453, 463, të KPPRK-së,

## G J Y K O N

Të akuzuarën, **me dënim me kusht**, ashtu që i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) muaj dhe dënim me gjobë në shumë prej 150€ (njëqindpesdhjetë/euro), të cilat dënime

nuk do ta ekzekutohen nëse e akuzuara brenda afatit prej 1 (një) viti nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nuk kryen veprë të re penale.

E akuzuara lirohet nga shpenzimet e procedurës penale, pasi që e njëjta është e gjendjes së rëndë ekonomike, përfituese e ndihmes sociale, vërtetuar me kartelen e ndihmes sociale nr. *numri...*, lëshuar me dt. 20.03.2017 në qendrën për punë sociale K. Podujevë.

E dëmtuara KEDS Distribucioni në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, ka parashtruar aktakuzën PP.II.nr.1216/14 të dt.23.02.2016, kundër të akuzuares **S. E.** nga fshati H., Komuna e P., për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 09.11.2017, gjatë të cilës u dëgjuan prokurori i shtetit Rexhep Maqedonci nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe e akuzuara.

E akuzuara në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale, kërkoj nga gjykata që të më shqiptoj një dënim sa më të butë pasi jam e gjendjes së rëndë ekonomiko-sociale.

Prokurori i shtetit në seancën e shqyrtimit fillestar lidhur me pranimin e fajësisë nga e akuzuara dha mendimin duke deklaruar se pajtohem me pranimin e fajësisë së të pandehurës sepse është konform dispozitave të KPRK-së.

Gjyqtari i vetëm gjykues vërteton se e akuzuara e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi i fajësisë u bë vullnetarisht nga e akuzuara, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që i përmban aktakuza në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje ligjore apo gabime faktike.

Gjykata pas pranimit të fajësisë nga ana e të akuzuarës, si dhe marrjes së mendimit të palëve, respektivisht prokurorit të shtetit, si dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës vërteton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara sipas dispozitës së nenit 248 par.1 të KPRK-së, dhe e aprovoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuares në shqyrtimin fillestar, andaj gjykata konform nenit 248 par.4 të KPRK-së, nuk ka zbatuar procedurën e provave por ka vazhduar me shqiptimin e dënimit.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta përjashtojnë përgjegjësinë penale të akuzuarit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar edhe nga vet e akuzuara, gjykata vërteton se me veprimet inkriminuese të të akuzuarës, përmbushen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, e për çka gjykata gjeti se e akuzuara në aspektin penal-juridik është përgjegjëse, për çka të njëjten e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënim si në dispozitiv të aktgjykimit.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së dhe në rastin konkret si rrethana lehtësuese gjeti faktin se e akuzuara gjatë shqyrtimit fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, për herë të parë ka ardhur në kundërshtim me ligjin, moshën e shtyrë-gjendjen e rëndë ekonomike-rast social, ndërsa si rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, prandaj gjykata ka shqiptuar dënimin si në dispozitiv të aktgjykimit, me bindje se ky dënim është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës së kryer penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe se me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 41 të KPRK-së, që të parandaloj kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave të tilla penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale - paushallit gjyqësor u morë në bazë të nenit 453 par.4 të KPPRK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimit të kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marr në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së, pasi që gjykata në shqyrtim gjyqësor nuk pati kërkesë nga pala e dëmtuar për kompensimin e dëmit dhe nuk pati ndonjë ekspertizë nga ekspertë të pavarur lidhur me vlerësimin e dëmit material të shkaktuar nga i akuzuari.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË**  
**Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal**  
**P.nr. 247/16 më dt.16.11.2017**

**Sekretare juridike,**  
Mihrie Krasniqi-Sheholli

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
Gazmend Bahtiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimin të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj gjykate.